



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 2 nën c. dhe d) nenit 52 paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040, nenit 10 nën pikën 4, nenit 18 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e X-të të rregullt, të mbajtur më 26.11.2015, mori këtë:

V E N D I M

Për

Vënie në diskutim publik të Planit Komunal për Eficiencë të Energjisë

I

Miratohet vendimi për vënie në diskutim publik të:

1. Planit Komunal për Eficiencë të Energjisë për komunën e Klinës

II

Plani si në pikën 1 të këtij Vendimi lëshohet në diskutim publik 15 ditë prej ditës së shpalljes në tabelën e shpalljeve dhe ueb faqen e Komunës.

III

Brenda 15 ditëve të diskutimit publik të gjithë qytetarët e Komunës së Klinës, personat fizikë dhe juridikë, si dhe të gjithë të interesuarit mund të marrin tekstin e Planit në Shërbimin për Punë të Kuvendit, në objektin e Komunës, si dhe vërejtjet dhe sugjerimet me shkrim mund të jepen pranë kësaj zyre.

IV

Vendimi është i plotfuqishëm që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës, respektivisht 15 ditë pas pranimit të vendimit nga Zyra e protokollit të MAPL.

V

Vendimi është transparent përmes: Tabelës së shpalljeve.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01 Nr. 06-5944/2015
Klinë, më 08.12 /2015



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi